



Instituti i Kërkimeve Urbane

## MANUALI PËR “PJESËMARRJEN QYTETARE”

Aktivitet e këtij projekti synonin të siguronin përfshirjen dhe mbështetjen qytetare për vendosjen e tarifave të reja të shërbimeve publike, në vecanti tarifat e ujit dhe të pastrimit, tarifa të caktuara në bazë të kostos së përlogaritur nga vetë njesitë e qeverisjes vendore. Gjatë diskutimeve nëpër qytetet ku zbatohet ky projekt, u diskutua për reagimet që do të kishin qytetarët nga rritja e tarifave dhe mundësitë për përfshirjen e tyre në këto procese.

Ky manual ka për qëllim të ndihmojë njesitë vendore të gjejnë mënyrat më të mira të bashkëpunimit me qytetarët, të marrë opinionet e tyre, t'i edukojë dhe ndërgjegjësojë qytetarët për rolin e tyre dhe të forcojë, me këto mjete, lidhjet ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë vendore pranë tyre.

Ky manual përfshin mjete komunikimi të aplikuar në disa prej qyteteve, dhe në fazën e dytë u përfshinë edhe qytet e Përmetit, Delvinës e Ersekës, dhe ide për mjete komunikimi që dolën nga këto takime.

Autorët e këtij manuali falenderojnë drejtuesit dhe stafin e bashkive të qyteteve Shkodër, Kavajë, Gjirokastrë, Rubik, Ersekë, Himarë, Përmet e Delvinë, për angazhimin dhe kontributin e vlefshëm të tyre në hartimin e manualit.

Falenderime të vecanta i takojnë edhe organizatave dhe individëve me eksperiencë në çështje të bashkëpunimit të qytetarve me njesitë e qeverisjes vendore, të cilët morën pjesë në takimin për testimin e manualit dhe bënë vërejtje e sugjerime që janë marrë parasysh në këtë variant përfundimtar të Manualit “Përfshirja Qytetare në procesin e vendim marrjes”.